



VENDIMI MBI PRANUESHMËRI

Data e miratimit: 19 qershor 2019

Nr. i lëndës: 2016-09

Milorad Trifunović

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 19 qershor 2019, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaël METTRAUX, kryesues
Znj. Anna BEDNAREK, anëtare

Assisted by:
Mr Ronald Hooghiemstra, Legal Officer

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 15 janar 2019,

I. PROCEDURA

1. Ankesa në këtë rast është regjistruar më 30 qershor 2016.
2. Me shkresën e datës 1 korrik 2016, Paneli ka informuar Misionin se ky rast ishte regjistruar.
3. Më 28 qershor 2017, Paneli i ka kërkuar këtij dhe ankuesve të tjerë që të japin informata shtesë lidhur me ankesat e tyre. Ankuesit fillimisht ishin përgjigjur përmes përfaqësuesit të tyre se nuk kishin informacione të mëtejshme lidhur me ato raste.

4. Më 20 shtator dhe 17 tetor 2017, Paneli I ka dërguar dy kërkesa shtesë përfaqësuesin e lartpërmendur për dhënien e informatave shtesë.
5. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar një përgjigje nga përfaqësuesi i ankuesve duke ofruar informata shtesë lidhur me dy raste, duke përfshirë edhe këtë të tanishmin.
6. Më 8 dhjetor 2017, Paneli ia ka dërguar një deklaratë të fakteve dhe pyetjeve shefit të misionit (ShM-së), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar atë që të parashtrijë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesat jo më vonë se datën 26 janar 2018.
7. Përmes letrës së datës 19 janar 2019, nga Misioni ishte kërkuar përsëri që të japë përgjigje për pyetjet deri më 16 shkurt 2019.
8. Vërejtjet e ShM-së u morën më 12 mars 2019, pas së cilës u janë komunikuar ankuesve për vërejtje shtesë.
9. Më 15 mars 2019, letra e ShM-së i ishte dorëzuar ankuesve për informim , të cilëve iu ishte dhënë afat deri më 15 prill 2019 për të bërë ndonjë parashtrisë të mëtejshme në përgjigje të asaj letre.
10. Ankuesi nuk ka shfrytëzuar mundësinë e ofrimit të parashtrësive shtesë.

I. PËRBËRJA E PANELIT

11. Pas dorëheqjes së një prej anëtarëve të tij të përhershëm, Paneli do të mbledhet në këtë çështje vetëm me dy anëtarë në përputhje me rregullat 11 dhe 14 të rregullores së punës së Panelit.

II. FAKTET

12. Më 22 qershor 1998, Miroslav Trifunović, një vëlla i ankuesit, Milorad Trifunović, ka shkuar në punë me autobus në minierën e Belaçevcit, Komuna e Fushë Kosovës. Ai dhe tetë punonjës të tjerë u kapën nga pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) në fshatin Graboc i Poshtëm, komuna e Fushë Kosovës. Miroslav Trifunović dhe punonjës të tjerë u urdhëruan të dilnin jashtë nga autobusi dhe u morën në një drejtim të panjohur. Nuk është dëgjuar nga ai që prej asaj kohe deri në datën e paraqitjes së kësaj ankese më 30 qershor 2016.
13. Ankuesi dhe familja e tij njoftuan Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK), Misionin Ndërkombëtar Civil (ICM), "Zyrën e SHBA" (kuptohet si referencë ndaj përfaqësimit diplomatik të SHBA-së në Prishtinë), Qendrën Kulturorë në Prishtinë dhe Ministrinë e Brendshme të Republikës së Serbisë dhe KNKK-në në Serbi, për zhdukjen e Miroslav Trifunovićit.

III. ANKESA DHE QENDRIMI

14. Ankuesi i referohet dy të drejtave të veçanta themelore të pasqyruara në dispozitat e mëposhtme: Nenit 2 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), nën drejtimin e saj procedural, i cili garanton të drejtën themelore të njeriut për jetën dhe ofron një detyrim për të hetuar rastet e vdekjeve të dyshimta; Nenit 3 të Konventës, i cili garanton të drejtën e një personi për të mos iu nënshtruar torturës ose trajtimit ose ndëshkimit çnjerëzor ose poshtëruës. Përveç këtyre dispozitave, Paneli vendosi *proprio motu* gjithashtu të komunikojë dhe të shqyrtojë rastin sipas neneve 8 dhe 13 të Konventës. Të njëjtat të drejta themelore të njeriut garantohen nga një numër i traktateve të tjera ndërkombëtare, duke përfshirë Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike. Këto të drejta janë pjesë e një grupi thelbësor të të drejtave themelore të njeriut, të cilat janë të garantuara për të gjithë si një çështje e së drejtës ndërkombëtare zakonore.
15. Duke konsideruar marrëdhënien e ngushtë të familjes ndërmjet viktimës së drejtpërcjettë - Miroslav Trifunović - dhe ankuesit - Milorad Trifunović - Paneli është i bindur që ankuesi mund të konsiderohet si viktimë sekondare e shkeljeve të supozuara dhe se si i tillë viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

IV. PARASHTRESËT E PALËVE NË LIDHJE ME PRANUESHMËRINË

Ankuesi

16. Siç përmbledhet më lart, ankuesi pretendon se gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, EULEX-i Kosovë duhet të kishte hetuar zhdukjen e vëllait të tij dhe ka dështuar ta bëjë këtë në kundërshtim me të drejtat themelore të tij dhe vëllait të tij.

Shefi i Misionit ("ShM")

17. ShM-ja merr parasysh juridiksionin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut në raste të ngjashme dhe mbi këtë bazë nuk e konteston pranueshmërinë e kësaj ankese sipas nenit 2 dhe 3 të Konventës.
18. Në parashtrimet e saj, ShM-ja vuri në dukje se si pjesë e procesit të transferimit të lëndëve dhe dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u në EULEX Kosovë gjatë periudhës dhjetor 2008 deri në mars 2009, një numër i dosjeve të policisë së UNMIK-ut duke iu referuar zhdukjes së nëntë individëve meshkuj më 22 qershor 1998 ishin transferuar në Mision; kjo përfshinte rastin e Miroslav Trifunovic-it. Këto zhdukje u regjistruan nga UNMIK-u nën tre numra të lëndëve. Dsa prej këtyre dosjeve arriten në Institutin e Mjekësisë Ligjore (EUM) të EULEX-it, ndërsa të tjerët iu dorëzuan Njesisë së EULEX-it për Hetimin e Krimeve të Luftës në Kosovë (NJHKL). Lidhur me këtë të fundit, dosja i është dorëzuar EULEX-it si një hetim i mbyllur për krime lufte dhe përmbajtja e tij është shqyrtuar në fillim të vitit 2009 nga NJHKL dhe nga një prokuror i EULEX-it në PSRK.

19. Informatat që gjenden në dosje sugjerojnë se rasti i Z. Trifunović ishte raportuar tek autoritetet serbe, Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) dhe UNMIK. Dosja gjithashtu përmban një deklaratë të babait të z. Trifunović drejtuar autoriteteve serbe të datës 13 qershor 2002.
20. ShM-ja tregon se derisa Misioni nuk është në gjendje të konstatojë nëse të afërmit e z. Trifunović kanë kontaktuar me NJHKL-në ose prokurorët e EULEX-it Kosovë, ata kanë qenë në kontakt me stafin e Institutit të Mjekësisë Ligjore "për disa vite".
21. ShM-ja gjithashtu dha një përshkrim të gjerë se si rastet e tilla janë shqyrtuar dhe regjistruar nga Misioni. Në këtë kontekst, ShM-ja vë në dukje se nga 5000 raste të personave të zhdukur të pranuar prej EULEX-i nga UNMIK-u, rreth 2000 ishin shënuar nga UNMIK-u si 'aktive' ndërsa 3000 janë shënuar si 'të mbyllura' - kategoria e fundit që i referohet atyre rasteve për të cilat mbetjet janë gjetur në kohën e transferimit. ShM-ja përshkruan më tej procesin e rishikimit dhe kategorizimit të dosjeve të pranuar nga OKB-ja, të cilat nuk duket se ishin sistemuar apo vendosur në dosje siç duhej. ShM-ja tregon se ky proces është penguar nga një numër faktorësh praktikë, duke përfshirë: mungesën e sistemit të menaxhimit të lëndëve; largimin e madh të stafit; si dhe rikonfigurimin e NJHKL-së në vitin 2014, që rezultoi me heqjen e kapaciteteve të inteligjencës dhe hulumtimit.
22. ShM-ja vë në dukje se dosja e Njësisë Policore për Personat e Zhdukur (MPU) që ka të bëjë me z. Trifunovic dhe të tjerët "duket se është transferuar vetëm tek stafi i EULEX-it Kosovë në Institutin e Mjekësisë Ligjore", pa ndonjë indikacion se NjHKL të EULEX-it Kosovë ka pranuar atë dosje. Sh-ja tregon se arsytet pse dosja u transferua në Institutin e Mjekësisë Ligjore është e panjohur.
23. Për dallim, pjesa e dosjes që lidhet me atë rast të mbajtur nga Njësia Qendrore e Hetimeve Penale të UNMIK-ut (NJQHPJ) është marrë nga NJHKL e EULEX-it Kosovë si pjesë e dorëzimit të dosjeve të lëndëve nga UNMIK-u dhe është dërguar në Prokurori të EULEX-it në PSRK për vlerësim më 14 janar 2009. Më vonë dosjen e lëndës i ishte caktuar një numër i PSRK-së.
24. Mbi këtë bazë, ShM-ja bën parashtresën si në vijim:

"Derisa mund të thuhet se EULEX-i Kosovë ishte njoftuar për zhdukjen e z. Trifunović pas transferimit të dosjeve nga UNMIK-u më 2008-2009, autoritetet e tij të policisë dhe prokurorisë u njoftuar vetëm në lidhje me informacionin që gjendet në dosjet e NjQHK/NjHKL-së dhe nuk ishin në dijeni se ekzistonte informata shtesë në një dosje të veçantë të transferuar tek stafi i EULEX-it Kosovë në Institutin e Mjekësisë Ligjore".
25. Në janar të vitit 2009, NJHKL e EULEX-it Kosovë ia dërgoi lëndën e NJQHPJ-së së UNMIK-ut në Prokurorinë e EULEX-it në PSRK për shqyrtim dhe vlerësim. Emrat e dy të dyshuarve u përmendën në një raport analitik të vitit 2007 që gjendet në dosje. I njëjti raport tregon se "nuk kishte prova për të mbështetur pretendimet kundër këtyre dy individëve". Dosja përmbante atë çfarë ShM-ja e përshkruan si "një numër shumë i kufizuar i dokumenteve dhe shumë pak informacion mbi Miroslav Trifunović-in".

26. Më 20 korrik 2009, Prokurori i EULEX-it në SPRK lëshoi Aktvendimin për heqjen e raportit të policisë së UNMIK-ut bazuar në nenin 208(1) të Kodit të Përkohshëm të Procedurës Penale të Kosovës. Arsyeja e këtij vendimi thuhet se ka qenë se dosja e lëndës nuk përmbante elemente që mund të çonin në identifikimin e një të dyshuari të mundshëm dhe gjithashtu se konsiderohej se hetimet e mëtejshme nga policia do të siguronin informacion të mjaftueshëm. Aktvendimi gjithashtu liston pesë palë të dëmtuara, duke mos përfshirë Z. Trifunović. Nga kjo ShM-ja sugjeron që prokurori i EULEX-it të mos ketë qenë në dijeni të informatave të tjera në dispozicion të Misionit në lidhje me z. Trifunović. ShM-ja thotë "aktualisht EULEX-i Kosovë nuk është në gjendje të shpjegojë pse rregullorja nuk i referohet të tetë personave të përmendur në dosjen e UNMIK-ut."
27. Në vitin 2011 dhe 2012, stafi i EULEX-it Kosovë në Departamentin e Mjekësisë Ligjore kreu gërmime në një vend ku besohej se trupat e nëntë të punësuarve të minierës të zhdukur mund të ishin varrosur. Gërmimi nuk ka çuar në ndonjë gjetje relevante.
28. ShM-ja gjithashtu vë në dukje se të dhënat e transferuara nga UNMIK-u nuk tregojnë se UNMIK-u kishte ndërmarrë hapa hetimor të rëndësishme para transferimit të dosjes së lëndës në EULEX Kosovë.
29. Dosja e lëndëve të PSRK-së ishte transferuar nga EULEX-i Kosovë në institucionet e Kosovës më 5 nëntor 2018. Letra përcjellëse që shoqëronte dosjen e lëndës tregoi se rasti ishte hedhur poshtë në korrik 2009, poi i kishte ftuar autoritetet kompetente të Kosovës për të bërë shqyrtimin e tyre të përmbajtjes së rastit dhe të kontaktojë NJHKL-në me qëllim që të verifikojë nëse ata ende kanë në posedim ndonjë material tjetër që ka të bëjë me rastin.
30. ShM-i tregoi se Misioni nuk ishte në dijeni për ndonjë hetim në proces e sipër nga autoritetet e Kosovës në lidhje me zhdukjen e Miroslav Trifunović-it.
31. Lidhur me karakterizimin ligjor të rasteve, ShM-ja thotë si në vijim. Qendrimi ishte marrë me sa duket në atë kohë se një rast të konsiderohej si rast "krim lufte", krimi duhet të kishte ndodhur mes periudhës së shkurtit 1998 dhe 21 qershorit 1999, kur konflikti i armatosur mendohet se ka ndodhur në Kosovë. Sipas "Ligjit mbi PSRK" dhe "Ligjit mbi Juridiksionin", në periudhën 2008-2014, prokurorët e EULEX-it Kosovë kishin kompetencë ekskluzive për të ndjekur penalisht rastet e krimeve të luftës dhe kategorive të tjera të krimeve të rënda. ShM-ja tregon në këtë drejtim se:

"Nga një rishikim i të dhënave të EULEX-it Kosovë del se kurdoherë që prokurorët e EULEX-it Kosovë kanë hasur në një dosje të lëndëve që kishin të bënin me vepra të pretenduara penale (përfshirë vrasjet dhe rrëmbimet) që kanë ndodhur pas dates 21 qershor 1999, ata e konsideronin veten pa kompetencë dhe i dërguan ato lëndë tek prokuroria përkatëse e Qarkut. EULEX-i Kosovë e kupton se sipas mendimit të Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut, një numër i këtyre rasteve mund të ishin hetuar nga PSRK si "krime lufte" ose "krime kundër njerëzimit" me kusht që elementet e këtyre veprave penale të konsideroheshin se ekzistonin. Megjithatë Misioni duhet të konkludojë se në

kohën përkatëse, autoritetet prokuroriale të EULEX-it Kosovë konsideronin se në dritën e burimeve të kufizuara në dispozicion dhe numrit të madh të lëndëve të krimeve të luftës, dërgimi i këtyre rasteve në Prokuroritë e Qarkut ishte rruga e duhur e veprimit”.

32. ShM-ja shton se, duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion të Misionit, NJHKL "u dha përparësi shqyrtimit të të ashtuquajturve 'dosjeve të krimeve të luftës ndaj 'dosjeve të personave të zhdukur'." ShM-ja gjithashtu vëren se EULEX-i Kosovë ka hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e zhdukjeve me forcë "në kuadër të rasteve të krimeve të luftës".
33. ShM-ja gjithashtu thotë se përpjekjet për t'i mbledhur të gjitha informatat në dispozicion të njërive të ndryshme të EULEX-it Kosovë në ZyLAB filluan vetëm në vitin 2017 dhe nuk mund të përfundoheshin para transferimit të lëndëve tek institucionet e Kosovës (në qershor 2018).
34. Parashtresat e ShM-së lidhur me bazueshmërinë e këtij rasti do të adresohen në një fazë të mëvonshme të procedurës.

V. VLERËSIMI I PANELIT

Mandati i Panelit (Rregulli 25, paragrafi 1 i rregullores së punës) dhe kompetenca ratione materiae

35. Siç është cekur më lart, ShM-ja nuk e konteston pranueshmërinë e kësaj lënde.
36. Duke shqyrtuar kërkesat përkatëse të pranueshmërisë, Paneli është i bindur se rasti është në të vërtetë i pranueshëm.
37. Si një çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar të zbatojë instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohet në Konceptin e Përgjegjshmërisë së EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet juridike demokratike.
38. Para shqyrtimit të ankesës mbi bazueshmërinë e saj, Paneli duhet të vendosë nëse duhet të vazhdojë me ankesat, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara në rregullën 29 të rregullores së punës.
39. Sipas rregullës 25, paragrafi 1, Paneli mund të shqyrtojë vetëm ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga EULEX-i Kosovë gjatë kryerjes së mandatit të tij ekzekutiv në sektorët e drejtësisë, policisë dhe doganave.
40. Paneli tashmë ka vendosur që veprimet e prokurorëve dhe policisë së EULEX-it janë pjesë e mandatit ekzekutiv të EULEX-it Kosovë dhe për këtë arsye bien në kuadër të

mandatit të Panelit (shih, për shembull, *K-T kundër EULEX-it*, 2013-05 në 2013-14, 21 prill 2015, para 43, *Krić kundër EULEX-it*, 2012-21, 26 gusht 2014, paragrafi 23, *Y kundër EULEX-it*, 2011-28, 15 nëntor 2012, paragrafi 35). Ky është rasti i veprimeve pozitive ose i dështimeve të fajshme.

41. Të drejtat që i nënshtrohen kësaj ankese janë ndër të drejtat më të rëndësishme prej të gjitha të drejtave themelore. Ata prekin interesat thelbësore të viktimave të supozuara dhe duhet të garantohen në të gjitha rrethanat. Praktika e zhdukjes me forcë përbën një shkelje të egër të këtyre të drejtave. Kjo reflektohet *ndër të tjera* në faktin se tani kjo konsiderohet dhe karakterizohet si një krim kundër njerëzimit, në veçanti, në Statutin e Gjykatës Ndërkombëtare Penale (Statuti i Romës, neni 7(1)(i)) dhe në Ligji mbi Dhomat e Specializuara dhe Prokurorisë Speciale (Ligji nr. 05/L-053) (Neni 13(1)(i)).
42. Paneli është i bindur që ngjarjet në shqyrtim kanë ardhur *ratione materiae* brenda fushës së përgjegjësisë së Misionit, në veçanti, por jo vetëm, përmes mandatit të prokurorëve të tij dhe Institutit të Mjekësisë Ligjore. Paneli thekson në këtë drejtim se dosja e lëndës në fakt ishte subjekt i një shqyrtimi nga EULEX-i Kosovë.
43. Implikimet e ndryshimeve në mandatin e Misionit pas përfundimit të mandatit ekzekutiv të Misionit në qershor 2018 dhe implikimet e tyre për qëllimin e këtij rasti do të adresohen, kur është e nevojshme, në vendimin e tij mbi bazueshmërinë. Palët janë të ftuara për të adresuar këtë çështje nëse dëshirojnë të bëjnë parashtresa të mëtejshme në lidhje me meritat e kësaj çështjeje.

Kompetenca ratione temporis

44. Kompetenca *ratione temporis* e Panelit nuk kontestohet nga ShM-ja, dhe Paneli është i bindur se kjo kërkesë është plotësuar dhe se ankuesi ka respektuar afatin e duhur 6 mujor brenda të cilit duhet të parashtrohet një ankesë.
45. Paneli thekson që *ratione temporis* është kompetent të shqyrtojë veprimet e Misionit deri më 14 qershor 2018. Pas kësaj date, Misioni nuk kishte ndonjë përgjegjësi ekzekutive mbi këtë rast. Megjithatë aktivitetet e kryera pas kësaj date mund të jenë relevante, për të vlerësuar shkallën në të cilën Misioni ka përmbushur detyrimet e tij ndaj të drejtave të njeriut. Rrjedhimisht, Paneli fton Misionin që të ofoj referenca në parashtrimet e veta për çfarëdo përpjekje të ndërmarrë nga Misioni për të siguruar që ky rast ishte duke u hetuar (nëse po), përfshirë pas kësaj date ose çfarëdo hapi tjetër që merret nga Misioni për përmbushjen e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut.

Kompetenca ratione personae

46. ShM-ja nuk e konteston kompetencën *ratione personae* të Panelit dhe Paneli është vërtetë i bindur që është kompetent edhe në këtë drejtim.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

SHPLL TË PRANUESHME, pa paragjykuar meritat e çështjes, ankesat lidhur me shkeljet e pretenduara të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;

KËRKON NGA PALËT që t'i adresojnë pyetjet në vijim:

I. PËR SHEFEN E MISIONIT:

- i. A i ishin shpërndarë dosjet që kishin të bënin me këtë rast në posedim të Institutit të Forenzikës ndonjëherë prokurorëve të EULEX-it? Nëse jo, cila është arsyeja?
- ii. Cilat hapa (nëse ka) janë marrë nga Misioni për të siguruar bashkërendimin ndërmjet organeve të ndryshme të tij për të centralizuar dhe shpërndarë informatat që kanë të bëjnë me hetimin në vazhdim e sipër të veprave të rënda penale, përfshirë rastet e "zhdukjeve me forcë"?
- iii. A është misioni kompetent për të monitoruar këtë rast pa autoritetet vendore që kanë filluar një hetim për të? Nëse jo, çfarë është Misioni i autorizuar të bëjë kur, sipas mendimit të tij, autoritetet vendore dështojnë të përmbushin obligimet e tyre procedurale sipas nenit 2 ose 3 të Konventës?
- iv. Gjithashtu ju lutemi të ofroni një kopje të letrës së datës 5 nëntor 2018 që përcjell transferimin e lëndëve tek autoritetet e Kosovës.
- v. Në parashtresat e veta, Misioni ka dhënë shenja se "është konsideruar jo e mundur që hetimet e mëtejshme nga policia do të siguronin informata të mjaftueshme" (shih, më lart, paragrafin 26). Cilat ishin faktorët apo konsideratat që çuan deri në atë përfundim? Nga kush është bërë kjo dhe kur?
- vi. Në parashtrimet e tij (të përmbledhura në paragrafin 21 më lart), Misioni tregon se si rezultat i rikonfigurimit të NJHKL-së në vitin 2014, kapacitetet e inteligjencës dhe hulumtimit ishin fshinë. Kush e mori atë vendim? Bazuar në çfarë faktorë dhe konsiderata?

II. PËR ANKUESIN:

- i. Çfarë kontaktesh keni pasur me Misionin e EULEX-it gjatë periudhës 2008-2014 në lidhje me këtë rast? Në veçanti, cili ishte natyra dhe niveli i kontakteve tuaja me Institutin Mjeko-Ligjor të EULEX-it?

- ii. A jeni informuar se në vitin 2009, EULEX-i Kosovë vendosi të mbyllë çështjen që ka të bëjë me zhdukjen e nëntë punëtorëve të minierës, duke përfshirë edhe të afërmin tuaj?
- iii. Ju lutemi përshkruani efektin - financiar, personal dhe emocional – që zhdukja e të afërmit tuaj ka pasur mbi ju.

Për Panelin

Z. Guénaël METTRAUX
Kryesues

Znj. Anna Bednarek
Anëtare